

BULETINI I LAJMEVE TË SIGURISË KIBERNETIKE

Shkurt 2019



8 rreziqet e sigurisë kibernetike që mund të ndikojnë në organizatën tuaj gjatë 2019.

Raporti i Riskut të Cyber Security 2019 i Aon përmban tetë rreziqe që mund të ndikojnë organizatat në 12 muajt e ardhshëm, pavarësisht se ku ndodhen në udhëtimin e tyre dixhital. Këto risqe përfshijnë teknologjinë, IoT, punonjësit etj.

<https://www.securitymagazine.com/articles/89864-cybersecurity-risks-that-may-impact-organizations-in-2019>



8 teste sigurie që duhet të ndërmarrin përdoruesit në vitin 2019.

Me organizatat që vazhdojnë të rriten në kompleksitet me përdorimin e arkitekturave hibride të TI-së që përfshijnë të dyja mjediset fizike dhe multi-cloud, nuk ka dyshim se siguria e aplikacioneve dhe të dhënave po bëhet më sfiduese.

<https://www.securitymagazine.com/articles/89837-vulnerabilities-penetration-testers-recommend-you-address-in-2019>



Siguria e shteteve.

Pavarësisht se disa shtete kanë anët e forta dhe të dobëta të sigurisë, ekziston një hapësirë e caktuar për përmirësim në secilën prej tyre. Kjo hapësirë mund të konsistojë në nevojë për të forcuar legjislacionin e tyre apo ndihmë për të siguruar mbrojtje më të mira në pajisjet e përdoruesve.

<https://www.securitymagazine.com/articles/89829-which-countries-have-the-worst-and-best-cybersecurity>

PËRMBAJTJA:

- Siguria e organizatës
- Siguria e përdoruesve
- Siguria e infrastrukturave kritike
- Aktivitete të AKCESK



“Safer Internet Day 2019”

Në datën 5 shkurt në ambjentet e Shkollës Kosova u zhvillua aktiviteti “Këshilluesit e vegjël për sigurinë online”. Nëpërmjet këtij aktiviteti, AKCESK, Ministria e Arsimit dhe Rinisë, me mbështetjen e UNICEF promovuan rëndësinë e mbrojtjes së fëmijëve në internet nëpërmjet zërit të fëmijëve. AKCESK dhe UNICEF synojnë të shtrijnë këtë nismë në nivel kombëtar, por këtë herë duke trajnuar dhe mësuesit e TIK, prindërit dhe nxënës të 30 shkollave në mbarë vendin.



“Angazhimet sektoriale në fushën e sigurisë”.

Në datën 6 shkurt 2019, u zhvillua Workshop-i për “Safer Internet Day 2019”, “Angazhimet sektoriale në fushën e Sigurisë”, i organizuar nga AKCESK.

Workshop-i kishte si qëllim njohjen me situatën aktuale në fushën e sigurisë në vend duke filluar nga Universitetet deri tek kërkesat e tregut për këtë fushë, nxitjen dhe mbështetjen e sektorit privat për identifikimin e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, unifikimin e politikave të sigurisë nga ISP-të për mbrojtjen e fëmijëve në internet dhe sensibilizimin e sektorit privat për zhvillimin e një fushate mbarëkombëtare mbi ndërgjegjësimin e qytetarëve për sigurinë e fëmijëve online.

Në fund të workshop-it u nënshkrua MoU midis AKCESK dhe AKEP.



Takimi i dytë i GNP për Strategjinë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike

Në datat 11 dhe 12 Shkurt u zhvillua takimi i radhës së GNP për Strategjinë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike. Takimi u zhvillua në kuadër edhe të Workshop-it me përfaqësues të UK National Cyber Security Center (NCSC). Takimi dy ditor ishte mjaft i vlefshëm për vazhdimin e fazave të tjera për hartimin e Strategjisë